

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008, “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Ky projektligj është pjesë e paketës fiskale 2015.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është ngushtësisht i lidhur me programin politik të qeverisë për stimulimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe agrobiznesit nëpërmjet uljes së kostove. Gjithashtu, ky projektligj propozon masa për lehtësimin dhe stimulimin edhe të sektorëve të tjerë të rëndësishëm, siç është sektori i përpunimit të nënprodukteve të naftës.

Projektakti nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë 4-mujorit të tretë të vitit 2014.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji propozohet në kuadër të paketës “Bujqësia”, e cila është një paketë e plotë masash për stimulimin dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe agrobiznesit për uljen e kostove dhe rritjen e rentabilitetit të

këtyre sektorëve. Ndër këto masa është bërja 0% e tarifës doganore për importin e produkteve që shërbejnë si lëndë të para për industrinë apo blegtorinë, të tilla si: gruri, ushqimi për kafshët, zogjtë njëditorë, derrat nën 30 kg, viçat nën 160 kg dhe mielli. Bërja zero e tarifës është propozuar edhe për sektorët e tjerë të rëndësishëm, siç është sektori i përpunimit të nënprodukteve të naftës duke synuar stimulim dhe lehtësim të këtij sektori.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përmban vetëm një nen, i cili përcakton reduktimin e tarifave doganore të disa produkteve. Ndryshimet kryesore janë:

- a) Ulja e tarifës doganore për naftën bruto prej 10 % në 0 %, e klasifikuar në kodin e Nomenklaturës së Kombinuartë Mallrave 2709 00 90 .
- b) Bërja 0 % e tarifës doganore për miellin e grurit, që aktualisht është 10 %. Efekti në të ardhura është minus 40 milionë lekë;
- c) Bërja 0 % e tarifës doganore për importin e produkteve që shërbejnë si lëndë të para për industrinë apo blegtorinë (si p.sh. gruri, ushqimi për kafshët, zogjtë njëditorë, derrat nën 30 kg, viçat nën 160 kg). Efekti në të ardhura është minus 150 milionë lekë;
- d) Bërja 0 % e tarifës doganore për materialin biologjik, që aktualisht është 10 %. Efekti në të ardhura është minus 1.2 milionë lekë;
- e) Bërja 10 % e tarifës për gomat e reja pneumatike, që aktualisht është 15 %.

kodi doganor	emertimi	tarifa doganore (MFN) %	Tarifa BE %	Tarifa CEFTA %
2709 00 90	- Të tjera	10	0	0
0511 10 00	--Spermat e gjedhëve meshkuj	10	0	0
1001 99 00	--të tjera	2	2	0
1001 19 00	--Të tjera	2	2	0
11010011	--prej grurit të fortë	10	10	0
11010015	--prej grurit të zakonshëm dhe grurit spelta	10	10	0
0103 91 10 100	derra me një peshë nën 30 kg	2	0	0
0102 29 29 100	gjedhë të një peshe më shumë se 80kg por jo më shumë se 100kg	2	0	0
0102 29 29 200	--gjedhë të një peshe më shumë se 100kg por jo më shumë se 160kg	2	0	0
2309 90 31	--që nuk përmbajnë produkte qumështi apo që përmbajnë më pak se 10% ndaj peshës produkte të tilla	2	0	0

Argumentet për këto reduktime tarifash doganore janë, si vijon:

Nafta bruto:

- Rafineria “ARMO” operon në dy rafineri, në Fier dhe Ballsh, përkatësisht me kapacitete përpunimi të naftës bruto prej 0.5 dhe 1 milion ton naftë bruto. Për nevoja teknologjike, rafineria përdor naftë bruto importi dhe naftë bruto vendase. Nafta e importit ka tarifë doganore 10 % dhe rritjet e çmimit të naftës bruto në tregun botëror ndikojnë në koston e lëndës së parë të rafinerisë;
- Vetëm Shqipëria aplikon tarifë doganore për naftën bruto;
- Rafineri të tjera përveç rafinerisë “ARMO” janë duke u zhvilluar dhe për vetë karakteristikat kryesore të zhvillimit të tyre, ulja e tarifës doganore të naftës bruto është e rëndësishme për uljen e kostove për të tilla rafineri.

Ulja e tarifës doganore për naftën bruto nga 10 % në 0 % vjen si mbështetje e qeverisë në uljen e kostove të prodhimit të rafinerive në vend, për t’i dhënë një stimul fiskal për vitin 2015 këtij sektori në synim rritjen e përpunimit të naftës bruto dhe rritjen e prodhimit vendas për nënproduktet e naftës.

Ulja e tarifës doganore 10 % të naftës bruto u analizua edhe nën një këndvështrim tjetër. Nafta bruto është trajtuar me tarifë doganore të lartë në import për të nxitur përpunimin e brendshëm të naftës bruto dhe prodhimin e brendshëm të nënprodukteve të naftës. Mirëpo, në kushtet e zhvillimit të teknologjisë së përpunimit të rafinerive, është e nevojshme përzjerja e naftës bruto të nxjerrë brenda vendit me naftën bruto të importuar. Kjo për arsye se nafta bruto e prodhuar në vend është shumë viskoze në krahasim me naftën e importuar. Kështu që mbajtja e tarifës doganore prej 10 %, tashmë, thjesht është

një tarifë me kosto për rafineritë, se sa një masë mbrojtëse për prodhimin vendas të naftës bruto.

Shqipëria është vend naftënxjerrës, me një nga pasuritë nëntokësore më të mëdha në vend. Mirëpo, pavarësisht kësaj ne importojmë tërësisht nënproduktet e naftës, për shkak të problematikave që ka pasur rafineria kryesore e përpunimit në vend. Rafineria “ARMO” përbën një kompani strategjike, si në terma të punësimit, ashtu edhe si tatimpagues kontributiv i rëndësishëm në të ardhurat tatimore, sidomos për akcizën. Vitet e fundit kjo rafineri e ka humbur rëndësinë e saj si kompani strategjike, me një kontribut modest në të ardhurat nga taksat. Për këtë arsye, synimi i qeverisë është rivitalizimi i rafinerisë “ARMO”, si dhe i zhvillimit të rafinerive të tjera, në rritjen e përpunimit të naftës bruto dhe rritjen e prodhimit vendas të nënprodukteve të naftës.

Lidhur me efektin në të ardhura nga kjo ulje, për vitin 2015 nuk është parashikuar efekt për arsye se për vitin 2013 dhe 9 mujorin 2014 nuk ka pasur importe të naftës bruto.

Vitet→	2009	2010	2011	2012	2013	9M 2014
Kodi 27090090						
Pesha kg	60,130,612	21,972,122	28,163,083	276,000	0	0
Vlera lekë	2,978,753,182	1,370,253,567	2,062,797,666	23,517,056	0	0
Taksa doganore	297,875,319	137,025,357	206,279,767	2,351,706	0	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Paketa “Bujqësia”

Bujqësia është trajtuar si sektor prioritar i qeverisë gjatë vitit 2014 dhe për këtë arsye ky sektor ka pasur një vëmendje të veçantë përsa i përket uljes së kostove të fermerit, nëpërmjet përjashtimeve dhe reduktimeve nga taksa të ndryshme. Kështu, në ligjin e ri “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, që hyri në fuqi në gusht 2014, u rikonceptua skema e kompensimit të fermerëve në masën 20 % nga 6 % që ishte më parë, masë e rëndësishme kjo në uljen me 20 % të kostove të fermerit për blerjet e lëndëve të para. Edhe në vitin 2015, ky sektor do të vazhdojë të jetë prioritar, bazuar në masat e përfshira në paketën “Bujqësia”, e cila është një paketë e plotë masash për stimulimin dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe agrobiznesit për uljen e kostove dhe rritjen e rentabilitetit të këtyre sektorëve.

Ndër këto masa veçohen:

1. Bërja 0 për qind e taksës doganore për miellin e grurit, që aktualisht është 10 %. Efekti në të ardhura është minus 40 milionë lekë.

Nga diskutimet e vazhdueshme me komunitetin e biznesit janë prezantuar shqetësimet që ka krijuar liberalizimi i tarifës së miellit nga vendet CEFTA për importuesit e të njëjtit produkt nga vendet e Bashkimit Evropian. Aktualisht, mielli, (klasifikuar në kodet tarifore 11010011 dhe 11010015) ka tarifë preferenciale 0 % me vendet e CEFTA dhe tarifë 10 % me vendet e tjera.

Në bazë të të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave rezulton se, që nga viti 2009, 80% e importit vjen nga vendet e CEFTA.

Viti 2013				9Mujor 2014			
Kodi Miell	pesha	Vendet	% ndaj totalit	Kodi Miell	pesha	Vendet	% ndaj totalit
11010011	1,460	BG	0	11010011	3	CN	0
11010011	1,308	DE	0	11010011	161,025	IT	0.49
11010011	3,659	FR	0.01	11010011	3,205,050	Serbi	9.68
11010011	251,030	GR	0.66	11010011	950	DE	0
11010011	122,091	IT	0.32	11010011	360	TR	0
11010011	7,700,000	Mali i Zi	20.19	11010011	1,454	FR	0
11010011	2,800	MK	0.01	11010011	21,381,199	Kosove	64.6
11010011	27,509,882	Kosove	72.15	11010011	937,793	GR	2.83
11010011	2,538,000	Serbi	6.66	11010011	7,412,500	Mali i zi	22.39
Totali	38,130,230				33,100,334		
Kodi Miell	Vit Wgt Net SUM	Vendet	% ndaj to	Kodi Miell	pesha	Vendet	% ndaj totalit
11010015	842	DE	0.01	11010015	991,408	GR	11.8
11010015	1,276,275	GR	14.21	11010015	1,069,000	BG	12.7
11010015	264	FR	0	11010015	65,000	Kosova	0.8
11010015	217,184	BG	2.42	11010015	3,159,670	Serbi	37.4
11010015	35,000	Kosove	0.39	11010015	890	DE	0
11010015	1,422,018	IT	15.83	11010015	2,160,000	TR	25.6
11010015	38,240	NL	0.43	11010015	971,414	IT	11.5
11010015	3,195,980	TR	35.58	11010015	20,000	MK	0.2
11010015	2,797,160	Serbi	31.14		8,437,382		
Totali	8,982,963						

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Gjithashtu, duke vlerësuar faktin se liberalizimi i plotë i tregtisë së produkteve bujqësore nga vendet CEFTA ka filluar zbatimin në vitin 2012, kuptohet që niveli i importit nga vendet CEFTA është rezultat i konkurrueshmërisë që kanë vendet CEFTA në lidhje me këtë produkt krahasuar me vendet e tjera, nga të cilat importohet mielli.

Duke vlerësuar nivelin shumë të ulët të importeve nga vendet jo CEFTA, si dhe duke mbështetur shqetësimin e ngritur për diferencimin e bërë në politikat mbrojtëse për këtë produkt, me argumentin se unifikimi i politikës tarifore për këtë produkt do të sjellë normalizim të tregut për këtë produkt dhe, si rezultat, edhe rënie të mëtejshme të çmimit të miellit, në përgjigje të shqetësimeve të importuesve të miellit, propozohet reduktimi i tarifës bazë nga 10 % në 0 % për kodet tarifore të mësipërme të miellit.

2. Bërja 0 për qind e taksës doganore për importin e produkteve që shërbejnë si lëndë të para për industrinë apo blegtorinë (si p.sh. gruri, ushqimi për kafshët, zogjtë njëditorë, derrat nën 50 kg, viçat nën 100 kg). Efekti në të ardhura është minus 150 milionë lekë.

Spektori i bujqësisë ka pasur një vëmendje të veçantë për shkak të vet strukturimit të ekonomisë ku bujqësia është një kontribut i rëndësishëm në Produktin e Përgjithshëm Bruto me 18 % - 20 %. Gjithnjë janë bërë përpjekje për stimulimin e zhvillimit të këtij sektori, por këto përpjekje kanë qenë sporadike dhe nuk kanë arritur të sjellin impaktin e tyre real në uljen e kostove të fermerit dhe uljen e kostove të industrisë së agropërpunimit. Për arsye të diversifikimit të nënsektorëve që përfshin "Bujqësia", qeveria hartoi një paketë të plotë masash fiskale dhe institucionale për të gjithë nënsektorët e "bujqësisë" me qëllim trajtimin thelbësor të problematikave që pengojnë zhvillimin e këtij sektori dhe adresimin me politika të qarta të stimulimit të zhvillimit të këtij sektori. Pjesë e këtyre masave janë edhe bërjet zero të tarifave doganore të disa produkteve që shërbejnë si lëndë të para për fermerin apo industrinë përpunuese në vend. Rikonceptimi i skemës së kompensimit të fermerëve me 20 % nga 6 % ishte masa e parë fiskale drejt uljes me 20 % të kostove të lëndëve të para të fermerit dhe formalizimit të të gjithë zinxhirit të transaksioneve fermer-grumbullues-përpunues. Vazhdimi i politikës së uljes së kostove të fermerit duke hequr tarifën doganore prej 10 % apo 2 % të lëndëve të para që përdor fermeri thellojnë më tepër uljet fiskale, me synimin e zhvillimit të këtij sektori. Nga bërja zero e disa tarifave doganore synohet:

- a) rritje e prodhimit vendas dhe investimeve në industrinë përpunuese dhe në fermat blegtorale;
- b) shfrytëzim më i mirë i kapaciteteve ekzistuese;
- c) ulje e importit të produkteve të gatshme ushqimore dhe kafshëve për therje;
- ç) rritje e punësimit në ferma dhe në industri;
- d) nxitje për kultivimin e tokave të papunuara me kultura foragjere për blegtorinë;
- dh) ulje e kostos së produkteve ushqimore për konsumatorin vendas;

- e) nxitje për zhvillimin e mekanizimit bujqësor dhe shërbimeve mbështetëse.

Ulje e taksave doganore vlerësohet të ketë një efekt negativ në të ardhurat nga taksa doganore në masën rreth 160 milionë lekë, minus të cilat do të kompensohen me rritjen e të ardhurave tatimore dhe sigurimeve shoqërore nga veprimtaritë prodhuese dhe formalizimi i tyre.

1. Bërja 0 për qind e taksës doganore për materialin biologjik, që aktualisht është 10 %.

Aktualisht, aplikohet një tarifë doganore prej 10 % e materialit biologjik elitare që përdoret nga fermeri/fermat shqiptare për të përmirësuar racën e kafshëve në funksion të rritjes së prodhimit. Mirëpo, kjo tarifë e lartë rrit kostot. Për këtë arsye, propozohet bërja zero e kësaj tarife, e cila sjell pritshmëritë e mëposhtme:

- a) Rritje të prodhimtarisë së qumështit dhe mishit;
- b) Ulje e importit të produkteve blegtorale;
- c) Përmirësim i vazhdueshëm racor përmes zgjerimit të tregut të brendshëm me raca të përmirësuara.

Efekti në të ardhura është minus 1.2 milionë lekë, të cilat, në bazë të vlerësimeve të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, do të kompensohen dhe do të tejkalohen me të ardhurat e rritura nga produkti blegtoral, të cilat përlllogariten rreth 400 mijë dollarë në vit, pas vitit të dytë.

Gomat e reja:

Propozohet që taksa doganore e gomave të reja të ulet nga 15 % në 10 %.

Aktualisht, për gomat e automjeteve (kodi tarifor 4011) paguhet taksë doganore 15 %, akcizë 20 lekë/kg dhe TVSH 20 %. Biznesi i importit të këtij artikulli ka kërkuar heqjen ose uljen e taksës doganore së gomave, duke argumentuar përse më poshtë:

1. Kjo tarifë ka mbetur e pandryshuar që nga viti 2002, pavarësisht marrëveshjes në kuadrin e OBT-së për uljen progresive të tyre. Ky mosndryshim krijon një diferencë të dukshme me të njëjtat mallra nga EU, të cilat tarifën e kanë 0 % ;

2. Tarifa në nivelin bazë për produkte të tjera të ngjashme me të njëjtën origjinë, si p.sh. pjesë - këmbimi, qofshin këto metalike ose të gomuara, është në nivelin 2 %, pavarësisht se goma është nga pjesët më të rëndësishme të sigurisë së automjetit. Pra, ka një diferencim edhe brenda të njëjtit grup, që është ai i pjesëve të automjeteve ndoshta për arsyen se gomat klasifikohen në kreun 4011 të Nomenclaturës së Kombinuar të Mallrave, ndryshe nga pjesët e tjera, të cilat klasifikohen në kapitullin 87;
3. Taksa doganore prej 15 % nuk justifikohet as me mbrojtjen e prodhimit vendas, sepse nuk ka asnjë prodhues të këtij produkti në Shqipëri;
4. Ulja e tarifës do të ulë diferencën në vlerë të gomave të reja me ato të vjetra, duke ndikuar në këtë mënyrë në uljen e importit të gomave të përdorura.

Efekti negativ në të ardhura është 33 milionë lekë në vit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTIO

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Financave ka hartuar projektligjin.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim shoqërohet me efekte financiare negative në shumën rreth 200 milionë lekë.

kodi doganor	emertimi	tarifa doganore %	vlera stat leke	Taksa Doganore	Efekti perfshire tvsh -ne
2709 00 90	- Të tjera	10	0	0	0
0511 10 00	--Spermat e gjedhëve meshkuj	10	30,167,621	1,604,587	1,925,504
1001 99 00	--të tjera	2	8,227,996,632	127,380,991	152,857,189
1001 19 00	--Të tjera	2	165,102,976	2,674,622	3,209,546
11010011	--prej grurit të fortë	10%	1,636,641,586	2,165,280	2,598,336
11010015	--prej grurit të zakonshëm dhe grurit spelta	10%	416,688,933	29,929,698	35,915,638
0103 91 10 100	derra me një peshë nën 30 kg	2	24,854,487	0	-
0102 29 29 100	gjedhë të një peshe më shumë se 80kg por jo më shumë se 100kg	2	0	0	-
0102 29 29 200	– gjedhë të një peshe më shumë se 100kg por jo më shumë se 160kg	2	0	0	-
2309 90 31	--që nuk përmbajnë produkte qumështi apo që përmbajnë më pak se 10% ndaj peshës produkte të tilla	2	187,150,676	50,890	61,068

KËSHILLI I MINISTRAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2014

PËR

NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008,
“PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Nivelet tarifore të disa artikujve, të përcaktuar në lidhjen nr.1, të ligjit nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, ndryshohen sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015.

K R Y E T A R I

ILIR META

Aneksi 1:

Kodi sipas NKM 2014	Emërtimi	Tarifa doganore Ishte	Tarifa Doganore Bëhet
2709 00 90	- Të tjera	10%	0%
0511 10 00	--Spermat e gjedhëve meshkuj	10%	0%
1001 99 00	--të tjera	2%	0%
1001 19 00	--Të tjera	2%	0%
1101 00 11	--prej grurit të fortë	10%	0%
1101 00 15	--prej grurit të zakonshëm dhe grurit spelta	10%	0%
0103 91 10 100	--derra me një peshë nën 30 kg	2%	0%
0102 29 29 100	gjedhë të një peshe më shumë se 80kg por jo më shumë se 100kg	2%	0%
0102 29 29 200	-- gjedhë të një peshe më shumë se 100kg por jo më shumë se 160kg	2%	0%
2309 90 31	--që nuk përmbajnë produkte qumështi apo që përmbajnë më pak se 10% ndaj peshës produkte të tilla	2%	0%
4011 (të gjitha kodet tarifore të kreut)	--Goma të reja pneumatike, prej gome	15%	10%